

VENDIM
Nr.715, datë 6.11.2007

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.253, DATË 27.4.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR CAKTIMIN E ELEMENTEVE TË SIGURISË DHE PËR MIRATIMIN E
FORMËS DHE TË MODELIT TË DOKUMENTIT TË IDENTITETIT TË SHTETASVE
SHQIPTARË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 6 e 8 të ligjit nr.8952, datë 10.10.2002 “Për dokumentin e identitetit të shtetasve shqiptarë”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.253, datë 27.4.2007 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

1. Paragrafi i gjashtë i pikës 2 “Elementet e sigurisë të vendosura në trupin e kartës”, të aneksit 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“- Bojë UV. Një simbol i printuar me bojë të dukshme, me sipërfaqe 100 mm², vetëm nën dritën ultravjollcë.”.

2. Në aneksin 2 të bëhen këto ndryshime:

a) paragrafi i dytë i pikës 2 “Përbërja e kartës” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Karta e identitetit do të jetë vetëm polikarbonat, e ndërtuar nga disa shtresa. Teknologjia e bashkimit të shtresave të kartës të sigurojë formimin e një trupi të vetëm dhe të pandashëm.”.

b) Në paragrafin “Dokumenti i identitetit ka dy faqe”, bëhen këto ndryshime:

“i) Fjalja e parë e pikës 1 “Faqja kryesore do të jetë ajo, në të cilën do të vendosen”, bëhet “- Fotografia e mbajtësit”.

ii) Pika 2 “Në faqen e pasme të kartës” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Chip-i me kontakt dhe pa kontakt. Përmasat e Chip-it dhe vendosja e tij në kartë do të jenë në përputhje me standardin ISO 7816.

- Do të jenë emërtimet e të dhënave të tjera të mbajtësit të dokumentit, me shkronja të vogla të shtypit.

Në gjuhën shqipe:

Ngjyra e syve, gjatësia, numri serial i dokumentit.

Në gjuhën angleze:

Eye colour, height, serial number.

- Do të jenë të dhënat e tjera (ngjyra e syve, gjatësia dhe numri serial i kartës), me shkronja të mëdha të shtypit.

- Në pjesën e pasme të kartës do të jetë një zonë e bardhë e painfluencuar nga sfondi, guilloshi, rainbow e të tjera teknika, të përdorura më sipër, kjo për të mundësuar leximin e qartë të kodit alfanumerik, që do të printohet në fazën e personalizimit. Printimi do të kryhet me OCR-B, zonë e lexueshme nga makinat, në përputhje me standardin ICAO 9303.

Ky kod do të lexohet nga makinat ekzistuese të pasaportave.

- Do të vendoset simboli sipas sipërfaqes së përcaktuar në aneksin 1.

- I paprintuar me mikrotekst do të jetë një tekst, me sipërfaqe totale shkrimi 100 mm².

- Dokumenti i identitetit do të ketë në të dyja faqet edhe një shtresë mbrojtëse, me shenja optikisht të variueshme të tipit OVD (optically variable devices), e cila do të ketë simbole e citime shqiptare.

Vendosja e të gjitha elementeve të disajnit, që përfshijnë:

- elementet grafike;

- elementet e sigurisë;

- elementet e rubrikave, përbërësit e gjendjes civile të mbajtësit, të dhënat shtesë të mbajtësit;

- kompozimi i shtresës mbrojtëse, si dhe pamja përfundimtare do të realizohen pas lidhjes së kontratës me kompaninë fituese.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha